



Doktorant (Phd Candidate) Muxhahid Ismaili

Bio e shkurtër

Muxhahid Ismaili, i lindur në vitin 1991, në Maqedoninë e Veriut – Shkup. Arsimin fillor dhe të mesëm e kam mbaruar në vendlindje. Studimet bacheloret (universitar) i kam përfunduar në Turqi pranë Universitetit “Istanbul Sehir University” në programin studimor: Shkenca Sociale dhe Humane– departamenti: Shkencat Politike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare (drejtimi anglisht) në vitin 2015. Studimet master i kam përfunduar në Universitetin e Europës Juglindore (SEEU-Maqedonia e Veriut), drejtimi: Diplomaci me temë: *“Koncepti i islamit politik tek Izetbegoviqi”*, viti 2019. Aktualisht doktorant pranë Universitetit European të Tiranës, programi i studimit: Shkenca Sociale dhe të Sjelljes, drejtimi: Fakulteti i Shkencave Juridike, Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Flas rrjedhshëm anglisht, turqisht, maqedonisht dhe boshnjakisht.

Titulli: Impaktet socio-politike të kufirit ideologjik në ndërtimin e nacionalizmit shqiptar.

Abstrakti

Punimi në fjalë, do të analizoj kalimin e kufirit Shqipëri-Kosovë/Jugosllavi gjatë periudhës 1944-1990, pra periudha e Luftës së Ftohtë, duke i zbërthyer fenomenin politico-sociale dhe ideologjike të nacionalizmit shqiptar në Ballkan. Qëllimi kryesor i studimit, mbetet të jetë analiza thelbësore e nocionit të kufirit, e cila përveç që ishte ndarje administrative, përkon me një realitet më tragjik të ndarjeve kombëtare kufitare, kujtesës historike shoqërore, kontrollit ideologjik dhe represionit shtetëror në kohë ilegaliteti. Në aspekt të metodologjisë së punimit, fokusi do të jetë në dokumentet historike të lëvizjeve politike apo studentore, literatura shkencore, dorëshkrimeve historiko-politike dhe studimeve krahasuese në aspekt politiko-social gjatë periudhës 1944-1990. Kjo qasje metodologjike, do të na mundëson që në mënyrë analitike studimit t’i qasemi përmes përvojave të kalimeve ilegale të njerëzve ose grupe ilegale, ndarjeve familjare dhe impaktit të protestave studentore në ruajtjen e nacionalizmit shqiptar ndër vite, ku roli i ilegalitetit ka qenë jetik për mbijetesën e shqiptarëve të ndarë në kufij, e të bashkuar në gjuhë, komb edhe atdhe. Burimet historike së bashku me përvojat kolektive, tregojnë se kufiri Shqipëri-Kosovë/Jugosllavi, nuk ishte veç ndarje fizike, por reflektim i ideologjisë që kishte për synim dëbimin e shqiptarëve nga trevat e tyre, ndalimin e rritjes së nacionalizmit shqiptar, izolimin politiko-shoqëror të saj, si dhe migrimin si traumë dhe fragmentim i nacionalizmit shqiptar. Si përfundim, punimi ka për qëllim

të argumenton se kufiri, lëvizjet politiko-shoqërore, ilegaliteti, impakti i protestave studentore kanë qenë shtylla themelore e ndërtimit të nacionalizmit kombëtar në këto troje.

Fjalët kyçe: kufiri Shqipëri-Kosovë/Jugosllavi 1944-1990, nacionalizmi shqiptar, kujtesa historike, ilegaliteti, lëvizjet dhe pasojat socio-politike.